



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Ministria e Shëndetësisë dhe
Mbrojtjes Sociale

Nr. 423, datë 26.01.2022

Ministria e Financave dhe
Ekonomisë

Nr. 425, datë 26.01.2022

URDHËR I PËRBASHKËT

Nr. 52, datë 26.01.2022

“PËR
MIRATIMIN E MEKANIZMIT TË REFERIMIT PËR PUNËSIMIN DHE INTEGRIMIN SOCIAL
TË INDIVIDËVE NË MOSHË AKTIVE PUNE”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 2 të nenit 19 të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë” dhe të pikës 24 të vendimit nr.822, datë 24.12.2019, të Këshillit të Ministrave “Për mekanizmin e bashkërendimit ndërinstitucional të punës për referimin për punësim të individëve dhe anëtarëve në moshë aktive pune të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike”,

URDHËROJMË

1. Miratimin e mekanizmit të referimit për punësimin dhe integrimin social të individëve në moshë aktive pune, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhëri.
2. Ngarkohen strukturat e përcaktuara për zbatimin e aktiviteteve të mekanizmit, për zbatimin e këtij urdhri.
3. Ngarkohen për ndjekjen e zbatimit të këtij urdhri struktura përgjegjëse për ndihmën ekonomike në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, struktura përgjegjëse për punësimin dhe formimin profesional në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Shërbimi Social Shtetëror dhe Agjensia Kombëtare për Punësim dhe Aftësim.
4. Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE

Ogerta MANASTIRLIU

MINISTRI I FINANCAVE
DHE EKONOMISË

Delina IBRAHIMAJ

MEKANIZMI I REFERIMIT PËR PUNËSIMIN DHE INTEGRIMIN SOCIAL TË INDIVIDËVE NË MOSHË AKTIVE PUNE PËR VITIN 2022

1	Krijimi Mekanizmit të referimit mbi të dhënat për punëkërkesit e papunë, përfitues të NE	1.1	Rakordimi i të dhënave të përfituesve në moshe aktive pune, përfitues të ndihmës ekonomike me punëkërkesit e papunë të regjistruar në Zyrat e Punësimit.	Lista emërore e përfituesve, nga 66.000 familjet nga skema e NE, në moshë aktive pune (20.000 të regjistruar në AKPA)	SHSSH AKPA	Janar-Shkurt 2022
	1.2	Analiza e profilit të punëkërkesve të e papunë, përfitues të NE. Evidentimi i situatës sociale –ekonomike të përfituesve të NE mbi: 1) grup-moshën, 2) vendodhjen gjeografike, 3) gjininë, 4) përbërjen familjare, 5) niveli arsimimit, 6) profesionin, 7) eksperiencën e punës, 8) trajnimet e ndjekura.9). kohëzgjatja në skemë.	Profili i individëve të punësueshëm të anëtarëve në moshë pune nga skema e NE.		MSHMS SHSSH	Shkurt - Prill 2022
	1.3	Sigurimi i aksesit nëpërmjet sistemeve elektronike, në kohë reale nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësisë dhe Shërbimi Social Shtetëror. Sigurimi i aksesit nga ana e AKPA në deklaratat tremujore të përfituesve të skemës së NE.	Ndërveprimi i sistemeve elektronike dhe përditësimi i tyre me listën e përfituesve të punësueshëm. (deri në 30.000/muaj anëtarë në moshë aktive pune).	AKPA SHSSH	Mars-Maj 2022	

				Draftimi dhe miratimi i një protokollit pune për të përcaktuar rolin dhe përgjegjësitë e aktorëve, koordinimin dhe bashkëpunimin si dhe shkëmbimin e të dhënave për përgatitjen e Planeve të Mbështetjes nga institucionet respektive përgjegjëse.	Protokoll i miratuar për (30 Plane Mbështetje në Muaj për çdo Rajon)	MSHMS MFE	Maj 2022
	1.4						
	1.5		Shërbimi Social Shtetëror referon listën me profilet e Përfituesve të NE pranë AKPA. Prioritizimi dhe pilotimi në ato rajone ku është numri më i lartë i individëve në moshe aktive pune dhe kanë nivelin arsimor e profesional të lartë.	Lista emërore e përfituesve të NE sipas analizës së profileve. (Target mujor SHSSH 20.000-30.000 persona)	SHSSH	Gjatë vitit 2022	
	1.6		Identifikimi dhe bashkërendimi i programeve sipas fushave të përgjegjësisë shtetërore të secilit institucion, me qëllim riintegrimin dhe punësimin e antarëve të familjeve të NE që janë në moshë aktive pune.	Skema aktive të nxitjes së punësimit (5 Programet e Nxitjes Punësimit)	AKPA SHSSH	Mars - Maj 2022	
	2.1	Përgatitja e kuadrit ligjor për zbatimin e planit të veprimit të daljes nga NE	Ngritja e Grupit të Punës Ndërinstitucional i kryesuar nga ministria e MSHMS me përfaqësues nga ministrinë e linjës (MFE, MBZHR, MTM, MIE, MB, FSHZH) për koordinimin e veprimtarisë në lidhje me identifikimin e programeve që kanë potencial punësimi për antarët e familjeve të skemës së NE që janë në moshë aktive pune.	Identifikimi i të gjitha programeve ku mund të kenë prioritet antarët e punësueshëm të familjeve në skemën e NE.	MSHMS MFE	Shkurt 2022	

Elbow me projekt
olew wjfeed
veshurat

	2.2	<p>Analizë e programeve me mundësi punësimi në fushën e bujqësisë, të mjedistit, punë komunitare, infrastrukturës, transportit, energjicitikës, të sipërmarrjes dhe biznesit etj</p>	<p>Target 1000 persona të punësuar në këto programe</p>	<p>MSHMS MFE MBZHR, MTM, MIE, MB, FSHZH</p>	Gjatë vitit 2022
	3.1	<p>Ngritja e grupeve të punës rajonale (DRSHSSH, DRPAP, NJVV dhe bashkitë) të cilët do të funksionojnë si një komision tregalësh për vlerësimin e aplikimit, profitit social ekonomik dhe përcaktimin e protokollit për riintegrimin social.</p>	<p>12 Grupe Rajonale 4320 raste të shqyrtuara në vit 30 raste/muaj për çdo grup rajonal</p>	<p>MSHMS MFE AKPA SHSSH</p>	Gjatë vitit 2022
	3.2	<p>Rishikim i detyrave dhe përgjegjësi të administratorëve social për përgatitjen e planeve të mbështetjes individuale. Ofrimi i asistencës për punësim që në momentin e aplikimit në njësinë vendore.</p>	<p>Rishikim i VKM-së për përcaktimin e detyrave dhe përgjegjësi të administratorëve sociale pranë NJVV</p>	<p>MSHMS MFE</p>	Prill-Maj 2022
3	3.3	<p>Riintegrimi i antarëve të familjeve të NE që janë në moshë aktive pune</p>	<p>Target mujor/vjetor</p>	<p>SHSSH AKPA</p>	Gjatë vitit
	3.4	<p>Punësimi nga shërbimet e punësimi, nëpërmjet ndërmjetësimit në punë, formit profesional dhe nxitjes punësimi të përfutësve në moshë aktive pune dhe riintegrimi social i tyre. Mbështetje me përparësi sipas VKM 17/2020 per: a) bonus per shpenzimet e transportit b) per prinderit e vetem me nje femije nen 6 (gjashte) vjeç bonus per ndjekjen e kopshteve dhe te çerdheve per femijet ne ngarkim.</p>	<p>4000 persona/vit 1000 persona formim profesional <i>po e lenda</i></p>	<p>SHSSH AKPA</p>	Gjatë vitit 2022
	3.5	<p>Informimi dhe ngritja e kapaciteteve të stafit të SHSSH, AKPA dhe strukturave të pushtetit vendor për përgatitjen e Planeve të mbështetjes Individuale (Plan Social dhe Plan Punësimi) për</p>	<p>2 trajnime çdo 6 muaj</p>	<p>SHSSH AKPA</p>	Gjatë vitit 2022

4	Monitorimi dhe implementimi i programit të daljes nga skema NE	4.1	përfituesit e NE të cilët do të dalin nga skema e NE.	Data base mbi rastet e shqyrtuara dhe të riinteguara	SHSSH AKPA	Gjatë vitit 2022	
			4.2	Përgatitja e raporteve mbi zbatimin e planeve të mbështetjes individuale dhe dinamikat e Programit të Daljes nga skema NE në lidhje me punësimin dhe aftësimin e individëve në moshë aktive pune. Evidentimi i problematikave dhe zgjidhja e tyre.	Raportet tre-mujore	MSHMS SHSSH AKPA	Gjatë vitit 2022
			4.3	Raportim mbi zbatimin e Dokumentit Indikativ Vjetor të integritit të përfituesve të ndihmës ekonomike në tregun e punës.	Raporti vjetor	MSHMS MFE SHSSH AKPA	Dhjetor 2022